



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 89

Tiranë – E premte, 21 qershor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 393, datë 19.6.2019	Për llojet e shërbimeve statistikore që ofron Instituti i Statistikave ndaj të tretëve kundrejt tarifave të paracaktuara..... 6375
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 394, datë 19.6.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 224, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 6375
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 19.6.2019	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.2.2017, për çështjen “Caka kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 74941/14) 6376
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 399, datë 19.6.2019	Për rregullat për shkëmbimin e grupeve dhe të shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore ndërmjet autoriteteve publike..... 6376
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 401, datë 19.6.2019	Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale te Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, të pasurisë së paluajtshme shtetërore nr. 10/46, ish-Materniteti Sarandë, në zonën kadastrale 8641..... 6378
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 402, datë 19.6.2019	Për lejimin e përdorimit të brigjeve dhe të sipërfaqes përpara resortit, në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “ <i>White Rocks</i> ” 6384
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 406, datë 19.6.2019	Për strukturat e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM). 6385
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 19.6.2019	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i segmentit rrugor Papër–Cërrik”..... 6385

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 410, datë 19.6.2019	Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 167/89, zona kadastrale 1031, Bashkia Durrës.....	6387
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 414, datë 19.6.2019	Për rregullat, kriteret dhe procedurat për përdorimin e shpellave për qëllime turistike.....	6394
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 415, datë 19.6.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 730, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, të ndryshuar.....	6395
	Korrigjim gabimi material në vendimin nr. 381, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyra të avokatisë vendase ose të huaja”.....	6396



VENDIM
Nr. 393, datë 19.6.2019

**PËR LLOJET E SHËRBIMEVE
STATISTIKORE QË OFRON INSTITUTI
I STATISTIKAVE NDAJ TË TRETËVE
KUNDREJT TARIFAVE
TË PARACAKTUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 36, të ligjit nr. 17/2018, “Për statistikën zyrtare”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Llojet e shërbimeve statistikore, që ofron Instituti i Statistikave ndaj të tretëve, kundrejt

SHTOJCA 1

LLOJET E SHËRBIMEVE STATISTIKORE QË OFRON INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr.	Shërbimet statistikore që ofrohen nga Instituti i Statistikave
1	Përpunim informacioni i detajuar nga databazat e brendshme sipas kërkesës së përdoruesit
2	Publikime të dedikuara për grupe të caktuara interesi
3	Vrojtime të plota ose procese të tyre

VENDIM
Nr. 394, datë 19.6.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 224, DATË 21.3.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME
PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË
USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE
TË ARMATOSURË TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 20, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

tarifave të paracaktuara, janë sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Procedurat e ofrimit të shërbimeve statistikore, të parashikuara në këtë vendim, përcaktohen nga Instituti i Statistikave me rregullore të posaçme, e cila publikohet në faqen elektronike të institucionit.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Statistikave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDOSI:

Në numrat rendorë 10, 11 e 12, niveli 3, të lidhjes nr. 5, që përmendet në pikën 5, të vendimit nr. 224, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, fjala “Kompanitë ...” zëvendësohet me fjalët “Kompania e Parë, e Dytë dhe e Tretë e Këmbësorisë ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 prill 2019.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**VENDIM****Nr. 396, datë 19.6.2019****PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË
GJYKATËS EVROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT, DATË 16.2.2017,
PËR ÇËSHTJEN “CAKA KUNDËR
SHQIPËRISË” (KËRKESA NR. 74941/14)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.2.2017, për çështjen “Caka kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 74941/14, për shumën 10 400 (dhjetë mijë e katërqind) euro, për kërkesën Kleopatra Caka, në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror, si dhe kostot e shpenzimet, duke e përfshirë nga çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlera e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të konvertohet në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohet në njërin nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkeses Kleopatra Caka, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 16.2.2017, për çështjen “Caka kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 74941/14.

4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3, të këtij vendimi, në favor të kërkeses Kleopatra Caka, të bëhet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit.

5. Mbi shumën e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, duke filluar nga data 16.5.2017, deri në datën e ekzekutimit të këtij vendimi, të paguhet interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM**Nr. 399, datë 19.6.2019****PËR RREGULLAT PËR SHKËMBIMIN E
GRUPEVE DHE TË SHËRBIMEVE TË
TË DHËNAVE GJEOPAPËSINORE
NDËRMJET AUTORITETEVE PUBLIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeopapësinor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

1. Bazuar në nenin 19, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeopapësinor në Republikën e Shqipërisë”, autoritetet publike shkëmbejnë ndërmjet tyre grupet dhe shërbimet e të dhënave gjeopapësinore, që kanë në administrim, vetëm për qëllime të realizimit të funksioneve të tyre publike.

2. Për të dhënat gjeopapësinore që janë bërë pjesë e GIS-it Kombëtar dhe janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar shkëmbimi do të bëhet nëpërmjet përdorimit të shërbimeve të rrjetit të



këtij gjeoportali, sipas përcaktimeve të kreut II, të këtij vendimi.

3. Për të dhënat gjeohapësinore që nuk janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar, deri në momentin e publikimit, shkëmbimi do të bëhet sipas përcaktimeve të kreut III, të këtij vendimi.

4. Në asnjë rast të dhënat apo grupet e të dhënave gjeohapësinore, të marra me qëllim realizimin e funksioneve publike, nuk mund të përdoren për qëllime të tjera apo t'u vihen në dispozicion të tretëve, me përjashtim të ASIG-ut.

5. Refuzimi për të vënë në dispozicion informacion gjeohapësinor, në çdo rast, duhet të jetë i argumentuar dhe bëhet objekt i shqyrtimit në Bordin për Informacionin Gjeohapësinor (BIG).

6. Kufizimet për shkëmbimin e informacionit gjeohapësinor, për çdo rast, bëhen me vendim të ASIG-ut, dhe vetëm për shkaqet e parashikuara në pikën 2, të nenit 19, të ligjit nr. 72/2012.

II. MARRJA E INFORMACIONIT NGA GJEOPORTALI KOMBËTAR NËPËRMJET SHËRBIMEVE TË RRJETIT (SHKARKIMI I TË DHËNAVE)

1. Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), në bazë të nenit 23, të ligjit nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, ofron për të gjithë përdoruesit shërbimet e rrjetit për aksesin në informacionin gjeohapësinor.

2. Për autoritetet publike që përdorin informacion gjeohapësinor për të realizuar funksionet e tyre publike, ky informacion ofrohet pa pagesë.

3. Aksesin për shërbimin e shkarkimit (shkëmbimin e të dhënave), për autoritetet publike, ofrohet nëpërmjet Gjeoportalit Kombëtar, pas pajisjes së autoritetit publik me kredencialet e nevojshme (*username, password*).

4. Pajisja e autoritetit publik me kredencialet e nevojshme nga ana e ASIG-ut bëhet vetëm pas kërkesës zyrtare me shkrim dhe përcaktimit prej tij të personit/ave përgjegjës.

5. Pasi analizohet kërkesa, drejtori i Përgjithshëm i ASIG-ut autorizon administratorin e sistemit për pajisjen e personave të autorizuar të autoritetit publik me kredencialet e nevojshme dhe lejon për të përdorur shërbimin e shkarkimit.

6. Llogaria e hapur në emër të autoritetit publik i dërgohet zyrtarisht institucionit.

7. Marrja e informacionit, për çdo rast, realizohet në mënyrë automatike nga sistemi, pas plotësimit të fushave të nevojshme, të përcaktuara në manualin e hartuar dhe të publikuar nga ASIG-u, në Gjeoportalin Kombëtar.

8. Arsytimi i kërkesës, bazuar në nevojën për kryerjen e funksioneve publike të institucionit, është kërkesë e detyrueshme, pa plotësimin e së cilës nuk mundësohet marrja e informacionit.

9. Lejimi për shkarkimin e informacionit apo refuzimi i tij i shkojnë autoritetit publik (kërkuesit) me *e-mail* duke i dhënë edhe *link*-un e shërbimit të shkarkimit në rastin e pranimit të kërkesës dhe arsyen e moslejimit të shkarkimit në rastin e refuzimit.

10. Përjashtimisht, kur mundësitë teknike nuk lejojnë shkarkimin e informacionit, ai ofrohet fizikisht, pas kërkesës me shkrim dhe vënies në dispozicion të pajisjeve të lëvizshme (*usb, cd, dvd, hardisk* i jashtëm) për depozitimin e informacionit.

III. MARRJA E INFORMACIONIT NGA AUTORITETI PUBLIK QË E ZOTËRON, NËPËRMJET KËRKESËS ME SHKRIM RAST PAS RASTI

1. Për të dhënat gjeohapësinore që nuk janë publikuar në Gjeoportalin Kombëtar i paraqitet kërkesë e argumentuar, me shkrim, autoritetit publik që i zotëron ato.

2. Në çdo rast kërkesa i dërgohet për dënim ASIG-ut, si autoritet kombëtar përgjegjës për informacionin gjeohapësinor.

3. Arsytimi i kërkesës, bazuar në nevojën për kryerjen e funksioneve publike të institucionit, është kërkesë e detyrueshme, pa plotësimin e së cilës nuk mundësohet marrja e informacionit.

4. Autoriteti publik, të cilit i është drejtuar kërkesa, vë në dispozicion të kërkuesit dhe të ASIG-ut të dhënat gjeohapësinore, duke përfshirë edhe metadatën përkatëse, brenda afateve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi.

5. Në rastin e refuzimit të kërkesës, për të vënë në dispozicion informacion gjeohapësinor, autoriteti publik që e zotëron atë duhet të arsyetojë refuzimin.

6. Ngarkohen Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave dhe



shërbimeve gjeohapësinore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

**VENDIM
Nr. 401, datë 19.6.2019**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E
SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE TE MINISTRIA E FINANCIVE
DHE EKONOMISË, PËR INSTITUTIN E
SIGURIMEVE SHOQËRORE, TË
PASURISË SË PALUAJTSHME
SHTETËRORE NR. 10/46, ISH-
MATERNITETI SARANDË, NË ZONËN
KADASTRALE 8641**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale te

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, të pasurisë shtetërore me nr. 10/46, ish-Materniteti Sarandë, me sipërfaqe 1842.26 m², në zonën kadastrale 8641, sipas të dhënave të pasurisë dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

2. Prona e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

3. Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore nuk mund ta tjetërsojnë apo t’ua japin në përdorim të tretëve pronën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.


4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**



PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT TEKNIK PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE NE ADMINISTRIM
TE MINISTRIS TE SHENDETESISE NE QYTETIN E SARANDES




TREGUESIT	
	KONTURI SHEREFQES TOTALE TE MATERNITETIT
	KONTURI I ODONES SE MATERNITETIT
	MURI KRETHJES MATERNITETIT
	SHESH PAS MATERNITETIT

Objekti: Përgatitja e Dokumentacionit Teknik për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shetërore në administrim të Ministrisë të Shëndetësisë në qytetin e Sarandës	Projekti: "Rrëni 95" Shpik	
	Liqenca Nr. 1865/11	
	Grupi i Projektimit	
	Projekti	Ing. Ruzhica NAJPI
Emertimi: Planifikimi dhe Organizimi i Maternitetit të Vjetër	Projekti	Ing. Arta NAJPI
	Projekti	Ing. Jeta AXHAM
	Topograf	Ing. Kullim ALLIU
Përshkrimi: Drejtorja e Shërbimit Spitalor Sarandë		Shk. 1:500
		Nr. 114



PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT TEKNIK PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHETERORE NE ADMINISTRIM
TE MINISTRISE TE SHENDETESISE NE QYTETIN E SARANDES



Objekti: Përgatitja e Dokumentacionit Teknik për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shetërore në administrativë të Ministrisë së Shëndetësisë në qytetin e Sarandës	Projekti: "Rean 95" Shpk Liqenca Nr. 18/57/11	
	Grupi i Projektimit	
Emërtimi: Planvendosja e Maternitetit të Vjetër	Projekti	Ing. Rozilja NAPI
	Projekti	Ing. Ana NAPI
	Projekti	Ing. Kras AXHAMI
	Topografi	Ing. Kujtim ALLIU
Porosues: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë	Shk. 1:500	Nr. FLS



Miratuar nga V. K. M. Nr. 519, Datë 7.11.1994

KARTELA E PASURISE SE PALUAJTSHME

Vol. 32 , Fq. 154

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

→ Vijn nga: Vol _____, Fq. _____

Zona Kadastrale: 8641 NR.i PASURISE: 10/46

Vijon në: Vol. _____, Fq. _____ deri në: Vol. _____, Fq. _____ →

Indeksi i Hartes: SR; E-9

Adresa e Pasurisë: Rrethi SARANDE Q/F SARANDE

PERFUNDIMTARE (data): 25/8/2013

Rr/L _____ P/G _____ SH _____ K _____ Ap _____

Përshkrim i veçantë:

MATERNITETI
7278

B - SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji i Pasurisë: **TRUALL** Brenda V.K.N. : **PO** Ref: **PL, RREG**

Sip. Totale e Pasurisë:	Nga Sip. Totale: sa Trual	Nga Sip. Truali: sa Ndërtesë	Per pjesen e përbashkët <u>PALLAT</u> Kuota e pjesmarries: _____ % Nr i Pasurise (pallat): _____ Vol. _____ Faqe. _____
1. <u>1.00</u> m ² Ref. <u>LN.10.10</u>	1. _____ m ² Ref. _____	1. _____ m ² Ref. _____	
2. <u>1,842.26</u> m ² Ref. <u>LN.10.2010</u>	2. <u>1,842.26</u> m ² Ref. <u>LN.10.2010</u>	2. <u>1,917.46</u> m ² Ref. <u>LN.10.2010</u>	
3. _____ m ² Ref. _____	3. _____ m ² Ref. _____	3. _____ m ² Ref. _____	
4. _____ m ² Ref. _____	4. _____ m ² Ref. _____	4. _____ m ² Ref. _____	

C - SEKSIONI I PRONESISE

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Pasap.	Vitet	Adresa e Prenarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
LN.10.10	17/07/2014	SI/TET					SARANDH				

Shënim: Kollona I/F/B tregon: I - individ, person fizik ose juridik; F - përfaqësues i familjes; B - bashkëpronar (%)



**D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PERDORIM, MARREVESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TIJERA**

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE CJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr.Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME SARANDI
Adresa: Rruga 11 Nentori Legj. Brigada 17 S (prane Prefektures)

SARANDË, me 8 1 2019
SHËNIM: Kjo kopje kartele në A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tone
Në regjistrin Vol 32, Faqe 154, Zona Kadastrale 8641, Qyteti Sarandë



**VENDIM****Nr. 402, datë 19.6.2019**

**PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË
BRIGJEVE DHE TË SIPËRFAQES
PËRPARA RESORTIT, NË FUNKSION
TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT
INVESTUES STRATEGJIK
“WHITE ROCKS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të sipërfaqes përpara resortit për realizimin e projektit investues strategjik “*White Rocks*”, Gjilekë, Dhërmi, Himarë, zona kadastrale 1739, i cili ka përfutur statusin e investitorit strategjik, procedurë e asistuar, me vendimin nr.15/3, datë 4.3.2019, të Komitetit të Investimeve Strategjike (në vijim “KIS”).

2. Afati për përdorimin e brigjeve, sipas këtij vendimi, do të jetë 20 (njëzet) vjet, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Bashkia Himarë ka detyrimin që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data e paraqitjes së kërkesës së investitorit strategjik “*Eurocol*” sh.p.k., të lidhë kontratën përkatëse për lejimin e përdorimit të brigjeve të detit, në përputhje me sipërfaqet dhe destinacionin e kërkuar nga subjekti, brenda koordinatave të sipërfaqes së lejuar nga vendimi i KIS-it.

4. Investitori strategjik “*Eurocol*” sh.p.k., duhet të paraqesë, pranë Bashkisë Himarë, kërkesën dhe dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) ekstrakt të 3 (tre) muajve të fundit, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

b) planvendosje të sipërfaqes, për të cilën subjekti kërkon të lidhë kontratë me njësinë e vetëqeverisjes vendore;

c) përshkrim të aktivitetit që do të realizojë në sipërfaqen për të cilën kërkon të lidhë kontratë.

5. Përdorimi i brigjeve do të kryhet përgjatë periudhës së sezonit veror, 15 maj–30 shtator, të

çdo viti, përkundrejt pagesës së tarifës, në përputhje me tarifën e plazheve, të përcaktuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë. Kjo tarifë do të aplikohet vetëm mbi sipërfaqen objekt kontrate, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi, të lidhur me Bashkinë Himarë, përgjatë periudhës së përmendur në këtë pikë.

6. Të ardhurat e mbledhura nga tarifa për dhënien e së drejtës së përdorimit të brigjeve administrohen dhe bëjnë pjesë në buxhetin e Bashkisë Himarë.

7. E drejta e përdorimit të brigjeve nga ana e investitorit strategjik “*Eurocol*” sh.p.k., me NUIS/NIPT J61810018B, koordinatat, sipërfaqja e lejuar për përdorim afatgjatë dhe kushtet e përdorimit bazohen në vendimin nr.15/3, datë 4.3.2019, të KIS-it, dhe në përputhje me përcaktimet e kontratës përkatëse që investitori strategjik duhet të lidhë me Bashkinë Himarë.

8. Ngarkohet Bashkia Himarë për lidhjen e kontratës përkatëse me investitorin strategjik, në zbatim të këtij vendimi. Në këtë kontratë të parashikohen shprehimisht të drejtat e detyrimit e autoritetit kontraktues dhe të drejtat e detyrimit e investitorit, në funksion të projektit të investimit strategjik, si dhe penalitetet përkatëse.

9. Ngarkohet Bashkia Himarë që, bazuar në vendimin e Komitetit të Investimeve Strategjike, të lidhë kontratë për dhënien me qira të sipërfaqes përpara resortit, me koordinata X=382288,649; Y=4445279,031; X=382253,017; Y=4445265,828; X=382338,982; Y=4445167,955; X=382370,780; Y=4445184,818; X=382347,882; Y=4445209,940, nën juridiksion të Bashkisë Himarë, sipas legjislacionit në fuqi, me afat për një periudhë 20-vjeçare, me kusht që investitori të mos ndryshojë destinacionin e pronës (përfshirë, por pa u kufizuar, ndërtimin, dhënien me qira palëve të treta).

10. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR

Erion Braçe

**VENDIM****Nr. 406, datë 19.6.2019****PËR STRUKTURAT E KOMITETIT
KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA
(KKDM)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 13, të ligjit nr. 8681, datë 2.11.2000, “Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, të cilët emërohen, si më poshtë vijon:

1.1 Kryetari dhe nënkryetari emërohen për një mandat 5-vjeçar (pesëvjeçar) nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën.

1.2 Sekretar i KKDM-së është sekretari i Sekretariatit Kombëtar të Digave të Mëdha (SKDM), pranë ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën.

1.3 Anëtarët emërohen për një mandat 4-vjeçar (katërvjeçar) nga ministri përgjegjës për infrastrukturën, sipas propozimeve të mëposhtme:

a) 2 (dy) anëtarë nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën (përfaqësues në fushën e energjisë dhe përfaqësues nga KESH-i);

b) 2 (dy) anëtarë nga ministria përgjegjëse për bujqësinë;

c) 1 (një) anëtar nga ministria përgjegjëse për emergjencat civile (që mbulon emergjencat civile);

ç) 1 (një) anëtar nga Universiteti Politeknik;

d) 1 (një) anëtar nga Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (specialist hidrolog);

dh) 1 (një) anëtar nga kryetari i Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha.

2. Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave (KTPD) përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, që emërohen, për një mandat 5-vjeçar, nga ministri përgjegjës për infrastrukturën, me propozim të kryetarit të Komitetit Kombëtar të Digave të

Mëdha (KKDM). Një prej anëtarëve do të jetë sekretar (specialist në SKDM) dhe një anëtar tjetër do të jetë përfaqësues i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.

3. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar, bëhet sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njëjësive të qeverisjes qendrore.

4. Mjediset e punës për KKDM-në, SKDM-ITD-në dhe KTPD-në sigurohen nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën.

5. Vendimi nr. 745, datë 20.10.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për strukturat e Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha (KKDM)”, të ndryshuar, shfuqizohet.

6. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR**Erion Braçe****VENDIM****Nr. 408, datë 19.6.2019****PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR
PAPËR-CËRRIK”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, si dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i segmentit rrugor Papër–Cërrik”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, për pasuritë e llojit “tokë arë”, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me një vlerë të përgjithshme prej 1 633 520.4 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet pikë katër) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë e llojit “tokë arë”, me vlerë 1 633 520.4 (një milion e gjashtëqind e tridhjetë e tre mijë e pesëqind e njëzet pikë katër) lekë, të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2019, për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga fondet e Autoritetit Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për

efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore Elbasan të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Drejtoria Vendore Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

Lista e pronarëve të pasurive, pronë private, që shpronësohen nga realizimi i projektit Ndërtimi i segmentit rrugor "Papër - Cërrik.

Nr	Emër Mbiemër	Lloji i Paturisë	Z. K	Nr. i Pasurisë	Sip. Totale m2	Sip. E shpronësuar m2	Çmimi lekë/m2	Vlera totale në lekë	Shënime Sqaruese
1	Qemal Mehmet Musai	Tokë arë	3702	40/2	4050	629	222	139638	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Bashkim Mehmet Musai	Tokë arë	3702	40/3	3050	416	222	92352	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Asllan Mehmet Musai	Tokë arë	3702	40/4	1660	272	222	60384	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Dervish Hajdar Asllani	Tokë arë	3702	40/7	4250	403	222	89466	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Dervish Hajdar Asllani	Tokë arë	3702	40/8	1339	181	222	40182	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Fadil Dervish Qosja	Tokë arë	3702	40/9	2300	336	222	74592	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Halim Beqir Qosja	Tokë arë	3702	40/10	4600	712	222	158064	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Bashkim Mehmet Musaj	Tokë arë	3702	40/15	14840	738	222	163836	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Mehmet Pasho Cenja	Tokë arë	3702	40/16	1000	303	222	67266	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Bashkim dhe Dylfiqare Musai	Tokë arë	3702	40/20	4400	422	222	93684	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Mustafa Hasan Rapi	Tokë arë	3702	41/2	1650	515	222	114330	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Bashkim Mustafa Vrap	Tokë arë	3702	41/3	300	214	222	47508	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Ferit Rapush Bullari	Tokë arë	3702	41/4	1600	167	222	37074	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Gazmend Alush Hida	Tokë arë	3702	41/5	3000	297	222	65934	Konfirmuar nga ZVRPP
15	BP Hida	Tokë arë	3702	41/6	3250	478	222	106116	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Zenel Xhafer Raga	Tokë arë	3702	41/8	5800	860	222	190920	Konfirmuar nga ZVRPP
17	Novruz Xhafer Raga	Tokë arë	3702	41/9	4000	15	222	3330	Konfirmuar nga ZVRPP
18	Novruz Xhafer Raga	Tokë arë	3702	41/10	1800	40	222	8880	Konfirmuar nga ZVRPP
19	Sulejman Pasho Cenja	Tokë arë	3702	37/5/1	3800	360.2	222	79964.4	Konfirmuar nga ZVRPP
Vlera totale paraprake						7358.2		1633520.4	

shënim: 1. Vlerësimi i pasurisë së llojit “tokë arë”, është kryer bazuar në VKM-në nr. 89, datë 03.02.2016.



VENDIM
Nr. 410, datë 19.6.2019

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË
STATUSIT, NGA KATEGORIA E
RESURSIT “TOKË BUJQËSORE” NË
“TOKË URBANE”, TRUALL, TË
PASURISË ME NUMËR 167/89, ZONA
KADASTRALE 1031, BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë

urbane”, truall, të pasurisë me numër 167/89, zona kadastrale 1031, Bashkia Durrës, sipas certifikatës së pronësisë të pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, Qarku Durrës, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit nga “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me numër 167/89, zona kadastrale 1031, Bashkia Durrës.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Durrës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1

Nr. rend.	Qarku	Bashkia	Zona kadastrale	Adresa e pasurisë	Numri i pasurisë	Sipërfaqja e pasurisë m ²	Sipërfaqja e zënë nga ndërtimi m ² pasuria 167/89	Sipërfaqja totale e ndërtimit m ² pasuria 167/89	Emërtimi i strukturës
1	Durrës	Durrës	1031	Arapaj	167/89, 164/5	9750	1469,4	1469,4	Kantinë vere “Bazilika e Shën Mëhillit”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

1758570

Zyra e Regjistrimit DURRES Zona Kadastrale Nr. 1031
 Numri i Pasurisë 164/5 Volumi 2 Faqe 195
 Adresa e Pasurisë ARRAPAJ
 Lloji i Pasurisë ARE
 Sipërfaqja Totale 6076m²
 Nga kjo : Sa Trusli — Nga kjo : Sa Ndërtesa —
 Nga pallat : Kuota e pjesëmarrjes — %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zot (Zotërinjë)		Pjesa	Adresa
Emri	Mbiemri		
<u>MUREME</u>	<u>MUSAI</u>	<u>F/B</u>	<u>ARRAPAJ</u>
<u>SHKELQIM</u>	<u>MUSAI</u>	<u>B</u>	<u>— " —</u>
<u>LULIETA</u>	<u>ÇIMO</u>	<u>B</u>	<u>— " —</u>
<u>ERMIRA</u>	<u>MUSAI</u>	<u>B</u>	<u>— " —</u>
<u>KLODËTAN</u>	<u>MUSAI</u>	<u>B</u>	<u>— " —</u>
<u>HAZBITE</u>	<u>GERDECI</u>	<u>B</u>	<u>— " —</u>

• është pronar i —
 • janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart 164/5
 • është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi —
 • kufizimet e pasurisë janë : V 164/7 L 164/10 S 164/7 P 164/7

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t)

me datë 25.10.2018 Nr. 21430

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI

Data e lëshimit të çertifikatës 27.11.2018

ZV/REGJISTRUESI
LEONARD KADRIANI



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PAUJATSHME

DURRES

REGJISTRUESI I RRETHIT
ARDIAN ILJAZI

**ZVRPP
DURRES**

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 1634 NR. PASURISE 16415 Viti 2 FOLIO 195
INDEKSI I HARTES K-24-100(2-6) SHKALLA 1:2500 SUP. 6076m²
ADRESA E PASURISE : Rrethi Durres Q. Krapec
Rr. PQ Sh. K-1

B. KUFIZIME

V. PASURIA Nr. 16417
L. PASURIA Nr. 16410
J. PASURIA Nr. 16417
P. PASURIA Nr. 16417

C. PRONARI
Mereme Musai

D. Data 26 / 10 / 2018 Or. 190
S. Mami



D - SEKSIONI I QIRAVE, NË PËRDORIM, MARRËVESHJEVE KATËZORË, SERVITUTAVE DHE INTERESAVE TË TJERA

Nr. Dok.	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lëvizjes së Çështjes	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TË GJYKATËS, KUFIZIMEVE etj.

Nr. Dok.	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lëvizjes së Çështjes	Shënime	Firma

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTËSHME DËRRËS

PASURIA ME NR. 164/5 VOL. 2 FO. 195
ËSHTË E NJËTË ME ORIGINALIN










Digitally signed by Nergjorë Isufi
DN: cn=AL, o=Durrës, ou=Land P
Architectural Designer
title=Administrative Engineering
Email=cn=Nergjorë Isufi
Date: 20190126 12:28:39 +0100

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

1852452

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. DURRËS Zona Kadastrale Nr. 1031

Numri i Pasurisë 167/89 Volumi 25 Faqe 234

Adresa e Pasurisë ARAPAJ

Lloji i Pasurisë ARE

Sipërfaqja Totale 3674.00 m2

Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa -

Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
ADELINA	MUHAMET	DEMIRI	1/1	

- është pronar i _____ pasurisë me numër 167/89

- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart _____

- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____

- kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 7/1/2019 Nr. 417

Data e lëshimit të çertifikatës 8/1/2019

Lëshues i çertifikatës
REGJISTRUESI
ARDIAN HAJAZI

Z.V.R.P.P. DURRËS



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
(Fragment)

**ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUEJTSHME
DURRËS**

REGJISTRUES
Ardian Haxhi

ZVRPP
DURRËS

Vula Firmë

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
ZONA KADASTRALE 1021
NR. I PASURISE 167/89 VOL. 25 FO 214
INDEKSI I HARTES K-34-100-2-G SHKALLA: 1:2500
ADRESA E PASURISE: Rrethi DURRËS Q/T ARAPAJ
Rr/L: P/G SH K 10

B. KUFIZIMET
V 405
L 167/90
J 167/85
P 167/85

C. PRONARI S.3674 m²
Adelina Mëkmet
Demos

D. Data: 08/01/2019 **Ora:** 3:49:04PM

X 429627.221 Y 4558298.438

X 429100.779 Y 4558298.438



**D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PËRDORIM, MARREYESHJEVE KUFIZUESE,
SERVITUTRAVE DHE INTERESAVE TE TJERA**

Nr Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Certifikatës	Shtezime	Firma

E - SEKSIONI I HIPOTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, etj

Nr Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Certifikatës	Shtezime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTËSISE
ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME DURRES
 Adresa: Rruga 11 Nëntori, Llogi Brigada 17 S (prane Prefektures)

DURRES, me 8 / 1 / 2019
 SHËNIM: Kjo kopje kontrollat A4, ka fuqi të njëjtë me origjinalin e ndodhur në zyrën tonë.
 Në regjistrin Vol. 25, Faqe 234, Zona Kadastrale 1031, Qyteti Durres

03/01/19





VENDIM
Nr. 414, datë 19.6.2019

**PËR RREGULLAT, KRITERET DHE
PROCEDURAT PËR PËRDORIMIN
E SHPELLAVE PËR QËLLIME
TURISTIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 18, të ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave, të kriterëve dhe të procedurave për përdorimin e shpellave për qëllime turistike, që synojnë miradministrimin dhe qeverisjen e kujdesshme, me qëllim mosdëmtimin e vlerave të tyre ekologjike, kulturore, historike, kurative, të gjetjeve paleontologjike, arkeologjike si dhe të mbishkrimeve prehistorike.

2. Shpellat që janë miratuar si monumente natyre administrohen nga strukturat e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (këtu e në vijim “AKZM”). AKZM-ja, në bashkëpunim me institucionet kërkimore e shkencore, harton planin e menaxhimit të shpellave. Për shpellat të cilat gëzojnë edhe statusin “pasuri kulturore”, AKZM-ja, në bashkëpunim me institucionet kërkimore e shkencore dhe strukturat përgjegjëse të specializuara për trashëgiminë kulturore, harton planin e menaxhimit të shpellave duke mbajtur në konsideratë kuadrin ligjor në fuqi për trashëgiminë kulturore. Planin e menaxhimit për të gjitha shpellat, monument natyre, miratohen nga ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura mjedisore jo më vonë se 2 vjet nga miratimi i këtij vendimi.

3. Shpella jepet në përdorim kur:

- a) është shpallur monument natyre;
- b) institucionet kërkimore-shkencore përkatëse kanë dhënë me shkrim deklaratën se ka përfunduar eksplorimi dhe studimi i saj si dhe kanë dhënë opinionin për mundësinë e dhënies së shpellës në përdorim, për qëllime turistike;
- c) ka përfunduar hartimi dhe miratimi i planit të menaxhimit të shpellës.

Mosplotësimi i njërës prej kushteve të mësipërme e bën të pamundur dhënien në përdorim të shpellës.

4. Në rast se shpellat e shpallura monumente natyre gëzojnë edhe statusin pasuri kulturore, përpara dhënies në përdorim merret mendimi i ministrisë përgjegjëse për kulturën.

5. Shpellat u jepen në përdorim për qëllime turistike subjekteve të interesuara që paraqesin një projekt teknik të përgatitur në përputhje me rregullat e përcaktuara në pikën 6, të këtij vendimi. Projekti teknik përpara miratimit, me qëllim sigurimin që ndërhyrjet e parashikuara nuk dëmtojnë në mënyrë të pakthyeshme integritetin ekologjik, arkeologjik, historik dhe vlerat e shpellës, i nënshtrohet për oponencë në institucionet kërkimore-shkencore. Në rastet kur shpellat gëzojnë edhe statusin pasuri kulturore kërkohet oponencë edhe nga strukturat e ministrisë përgjegjëse për kulturën, Institucionet kërkimore-shkencore/strukturat përgjegjëse për kulturën duhet të shprehen brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga paraqitja e projektit dhe mosdhënia e mendimit brenda afatit të kërkuar nuk pengon vijimin e procedurave.

6. Projekti teknik merr në konsideratë rregullat e përcaktuara në planin e menaxhimit të shpellës, karakteristikat dhe përbërësit individualë të shpellës dhe që nënkupton ndërhyrjet dhe veprimet mbrojtëse, restauruese, ngritjen e infrastrukturës, sistemet e kalimit, të ndriçimit, të kullimit të ujërave dhe të ajrit, krijimin e mjedisve muzeore të njeriut të shpellave dhe të kafshëve të hershme.

7. Ky projekt teknik paraqitet për miratim pranë AKZM-së dhe pas miratimit të tij subjektit të interesuar i lind e drejta e paraqitjes së kërkesës pranë këtij institucioni, për marrjen në përdorim të shpellës për qëllime turistike.

8. Subjekti i interesuar, bashkë me kërkesën, dorëzon pranë AKZM-së edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) regjistrimin pranë QKB-së si person fizik apo juridik;
- b) përshkrimin e hollësishëm të veprimtarisë për qëllime turistike që do të ushtrojë në shpellë;
- c) vetëdeklarimin me anë të së cilës deklaron se siguron mbrojtjen e vlerave të shpellës, mirëmbajtjen e saj me shpenzimet e veta, ruajtjen e mikroklimës të regjimit ujor, të ekosistemeve,



të tipareve gjeologjike dhe geomorfologjike, të gjetjeve paleontologjike e arkeologjike, si dhe të gjallesave.

9. AKZM-ja, pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të kërkuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës dhe dokumentacionit përkatës nga subjekti i interesuar, bën vlerësimin e saj duke përgatitur një raport përmbledhës dhe e përcjell për miratim te ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura mjedisore.

10. Në rast se AKZM-ja konstaton se kërkesa e paraqitur nga subjekti i interesuar nuk plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim, AKZM-ja njofton subjektin për plotësimin e dokumentacionit brenda 10 (dhjetë) ditëve nga paraqitja e kërkesës. Mosplotësimi i dokumentacionit brenda afatit të kërkuar përbën kusht për refuzimin e kërkesës.

11. Pas miratimit nga ana e ministrit përgjegjës për zonat e mbrojtura mjedisore të marrjes në përdorim të shpellës, subjekti i interesuar, qoftë ky person fizik apo juridik, nënshkruan brenda 10 (dhjetë) ditëve kontratën e marrjes në përdorim me AKZM-në, e cila përmban rregullat e përdorimit të shpellës.

12. Afati i marrjes në përdorim të shpellës është 5 vjet, me të drejtë rinovimi.

13. Tarifa e marrjes në përdorim të shpellës llogaritet sipas aktit nënligjor për të ardhurat e gjeneruara nga tarifat, masa dhe kriteret e përdorimit të tyre, që autorizon ligji nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”.

14. Personi fizik apo juridik, që ka marrë në përdorim shpellën, nuk mund t’ia japë atë një personi tjetër ose të ndryshojë destinacionin e veprimtarisë për të cilin e ka marrë në përdorim apo të kryejë ndërhyrje jashtë projektit dhe të pamiratuara nga organet kompetente.

15. Personi fizik apo juridik, që ka marrë në përdorim shpellën, gjatë ushtrimit të veprimtarisë për qëllime turistike, është i detyruar të respektojë tarifat e përcaktuara për hyrjen në shpella.

16. Operatori turistik, udhërrëfyesit turistikë, vendas ose të huaj, të certifikuar si dhe vizitorët janë të detyruar të respektojnë rregullat e administrimit dhe përdorimit të shpellave. Ndalohe marrja e objekteve të ndryshme nga shpella, prekja me dorë apo me mjete të

ndryshme të mjedisit të brendshëm të shpellës, të stalagmiteve dhe stalaktiteve, ndotja e mjedisit të brendshëm, hedhja e mbeturinave, keqpërdorimi i shpellave dhe i infrastrukturës mbështetëse.

17. Inspektorati përgjegjës për mjedisin dhe agjencitë rajonale të zonave të mbrojtura (ADZM), sipas kompetencave, kontrollojnë përdorimin e shpellës, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura”, me përcaktimet e bëra në këtë vendim dhe në kontratën e nënshkruar.

18. Ndaj vendimit të Inspektoratit të Mjedisit, përdoruesi i shpellës ka të drejtën e paraqitjes së ankimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

19. Vendimi nr. 807, datë 4.12.2003, i Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e dhënies në përdorim të shpellave”, shfuqizohet.

20. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 415, datë 19.6.2019

PËR DISA SHITESA DHE
NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 730,
DATË 20.10.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES PËR KUSHTET,
KRITERET, TARIFAT, AFATET DHE
PROCEDURËN PËR KLASIFIKIMIN E
STRUKTURAVE AKOMODUESE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 45, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në tekstin e rregullores së miratuar me vendimin nr. 730, datë 20.10.2016, të Këshillit të



Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në nenin 1 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) në pikën 1 pas fjalës “... klasifikimin ...” shtohen fjalët “... dhe kategorizimin ...”;

b) pika 4 shfuqizohet.

2. shkronja “c/1”, e pikës 2, të nenit 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c/1 “Dokument kategorizimi” është certifikata e lëshuar nga Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike për përmbushjen e kriterëve lidhur me llojin e strukturës akomoduese.”.

3. Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

a) pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Çdo sipërmarrës turistik që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese duhet të pajiset me dokument kategorizimi, i cili është i nevojshëm për përfitimin e lehtësirave fiskale, sipas legjislacionit në fuqi. Mënyra, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese përcaktohen me rregullore të miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.”.

b) pika 4 shfuqizohet.

4. Në pikën 1, të nenit 5, shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Kategorizimi i çdo strukture akomoduese bëhet sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 4.”.

5. Neni 7/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 7/1

1. Përjashtimisht, deri në nënshkrimin e marrëveshjes me agjenci apo organizata

ndërkombëtare të mirënjohura në fushën e vlerësimit të strukturave akomoduese, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1, të këtij neni, verifikimi dhe vlerësimi i strukturave akomoduese me 4 apo 5 yje, që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “Brand name”, bëhet nga ministria përgjegjëse për turizmin, me kërkesë të vetë sipërmarrësit turistik.

2. Procedura e klasifikimit për strukturat akomoduese me 4 apo 5 yje, që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe të njohur ndërkombëtarisht “Brand name”, përcaktohet në rregulloren e miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për turizmin.”.

II. Ngarkohet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin nr. 381, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për përzgjedhjen, kontraktimin e pagesën e avokatëve ose zyrate të avokatisë vendase ose të huaja”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86, datë 14 qershor 2019 bëhet korrigjimi i gabimit material:

Në fund të shkronjës “c”, të pikës 21, të vendimit **shprehja “100 x” zëvendësohet me “20 x”.**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë